



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 254/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.04.2018 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

Objekt:

Shfuqizim i vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e operatorit ekonomik “Laser Med” sh.p.k. nga procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*” me objekt: “*Blerje materiale mjekësore të mjekimit, kite reagente dhe materiale konsumi për Laboratorin e Biokimik-Klinik në QSUT; Loti 10: Tuba dhe konsumabile laboratorike për fazën preanalitike të përpunimit të gjakut*”, me nr. REF-42098-01-25-2018, me fond limit 14.608.500 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 12.03.2018, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

Ankimues:

“Laser Med” sh.p.k.
Rruga e Elbasanit, Mjull-Bathore, Nr. 4, përball TEG, Farkë, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”
Rruga e Dibrës, Nr.372, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

Public Health Sector

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 26.01.2018, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në sistemin e prokurimeve elektronike në faqen e Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur” me objekt: “Blerje materiale mjekësore të mjekimit, kite reagente dhe materiale konsumi për Laboratorin e Biokimik-Klinik në QSUT; Loti 10: Tuba dhe konsumabile laboratorike për fazën preanalitike të përpunimit të gjakut”, me nr. REF-42098-01-25-2018, me fond limit 14.608.500 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 12.03.2018, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

II.2. Në datën 12.02.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht:

- | | |
|--------------------------------|------------------------------|
| 1. “Laser Med” sh.p.k. | 4.930.000 lekë, skualifikuar |
| 2. “Biometric Albania” sh.p.k. | 5.189.000 lekë, kualifikuar |
| 3. “Euromed” sh.p.k. | 5.970.000 lekë, kualifikuar |
| 4. “Fedos” sh.p.k. | 6.120.000 lekë, kualifikuar |

5. “Krijon” sh.p.k.	6.170.000 lekë, kualifikuar
6. “Pegasus” sh.p.k.	7.870.000 lekë, kualifikuar
7. “ALMedikal” sh.p.k.	8.004.150 lekë, skualifikuar
8. “Biomedica Albania Distribution” sh.p.k.	9.381.000 lekë, skualifikuar
9. “Medial” sh.p.k.	10.740.000 lekë, skualifikuar
10. “O.E.S Distrimed” sh.p.k.	12.597.000 lekë, skualifikuar
11. “Genius” sh.p.k.	12.680.000 lekë, skualifikuar
12. “Seissmed” sh.p.k.	12.740.000 lekë, kualifikuar

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe nga verifikimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), rezulton se në datë 12.04.2018, autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës së mësipërme të prokurimit, ku rezulton klasifikimi i mëposhtëm:

1. “Laser Med” sh.p.k.	4.930.000 lekë, skualifikuar
2. “Biometric Albania” sh.p.k.	5.189.000 lekë, kualifikuar
3. “Euromed” sh.p.k.	5.970.000 lekë, kualifikuar
4. “Fedos” sh.p.k.	6.120.000 lekë, kualifikuar
5. “Krijon” sh.p.k.	6.170.000 lekë, kualifikuar
6. “Pegasus” sh.p.k.	7.870.000 lekë, kualifikuar
7. “ALMedikal” sh.p.k.	8.004.150 lekë, kualifikuar
8. “Biomedica Albania Distribution” sh.p.k.	9.381.000 lekë, skualifikuar
9. “Medial” sh.p.k.	10.740.000 lekë, skualifikuar
10. “O.E.S Distrimed” sh.p.k.	12.597.000 lekë, skualifikuar
11. “Genius” sh.p.k.	12.680.000 lekë, skualifikuar
12. “Swissmed” sh.p.k.	12.740.000 lekë, kualifikuar

II.3. Në datën 19.03.2018 operatori ekonomik “Laser-Med” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi. Referuar “Proces-Verbalit të Vlerësimit”, të mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, më datë 19.03.2018, oferta e operatorit ekonomik “Laser Med” sh.p.k. skualifikohet për arsyet si më poshtë vijon:

- Katalogu i të 2 prodhuesve, perkatesisht Demophorius dhe Voxtur, nuk janë dorëzuar të perkthyer dhe noterizuar, sipas kërkesës nëDST pika 2.3/dh;
- Nuk është dorëzuar kopje e certifikatës për normat 98/79/EC për Demophorius, OE ka dorëzuar një deklaratë eksporti të leshuar nga Ministria e Shëndetësisë/Qipro, jo sipas kërkesës ne DST pika 2.3/ç;
- Formulari ofertës nuk është i qarte, pasi OE ka deklaruar për secilin Artikull 2 Prodhues dhe 2 vende origjine pa detajuar nga prodhuesin për secilin mostër;
- OE ka dorëzuar vetëm autodeklarate e konformitetit për normen 98/79/EC për Voxtur, pa kopje të certifikatës bashkëngjitur; sipas kërkesës ne DST pika 2.3/ç.
- Kontrata e Huapërdorjes, bashkëngjitur vertetimit të OShEE, nuk është nënshkruar para noterit si dhe nuk është e periudhës aktuale (dt. e kontratës është 05.10.2018 - 31.12.2018).
- Mostra e dorëzuar për artikullin 1 dhe 3, të Voxtur, nuk janë në përputhje me katalogun e dorëzuar për këto kompani. KVO ka krahasuar 4 Tubat të cilët etiketimin e kanë të ndryshëm dhe përkatësisht:

- Tubat me tapër jeshile (Artikulli 1) dhe lejla (Artikulli 3) emri Vactube është i shënuar në fushë me ngjyrë të njëjtë me Tapën: kanë etiketim me fushë të ndarë ku mund të shkruhen të dhënat e pacientit/gjakut: emri, mbiemri, data etj. Tubat kanë shenjën CE në etiketë dhe kanë të shkruajtur në etiketë emrin e prodhuesit Voxtur Bio LTD. Nga krahasimi me fotot në katalogun e dorëzuar nga OE për prodhuesin Voxtur, këto tuba rezultojnë se nuk janë të ngjashëm me Tubat me tapër jeshile dhe lejla në katalog.
- Tubat me tapë të kuq (Artikulli 4) dhe bojëqiell (Artikulli 2) emri Vactube nuk është i shënuar në fushë me ngjyrë të njëjtë me Tapën; kanë etiketim me fushë të bardhë, pa ndarjet ku shkruhen të dhënat e pacientit/gjakut: emri, mbiemri, data etj. Tubat nuk kanë shenjën CE në etiketë dhe nuk kanë të shkruajtur në etiketë emrin ose logon e prodhuesit Voxtur Bio LTD. Nga krahasimi me fotot në katalogun e dorëzuar për Voxtur, këto tuba rezultojnë se nuk janë të ngjashëm me Tubat me tapë të kuqe dhe bojëqiell në katalog.

II.4. Në datën 26.03.2018 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e tij. Konkretisht në ankesë pretendohet si më poshtë vijon:

[...]

Oferta është refuzuar (Njoftimi dates 19.03.2018), me arsyetimin se me dokumentacionin e paraqitur për plotësimin e kriterëve të kualifikimit rezultojnë;

- Formulari ofertes nuk është i qartë, pasi OE ka deklaruar për secilin Artikull 2 Prodhues dhe 2 vende origjine;
- Katalogu i të 2 prodhuesve, perkatesisht Demophorius dhe Voxtur, nuk janë perkthyer dhe noterizuar, sipas DST pika 2.3/dh;
- Nuk është dorëzuar kopje e certifikatës për normat 98/79/EC për Demophorius, OE ka dorëzuar një deklaratë eksporti të leshuar nga Ministria e Shëndetësisë/Qipro, jo sipas kërkesës në DST pika 2.3/ç. OE ka dorëzuar vetëm autodeklarate të konformitetit për normen 98/79/EC për Voxtur, pa kopje të certifikatës bashkëngitur; sipas kërkesës në DST pika 2.3/ç.
- Mostra e dorëzuar për artikullin 1 dhe 3, të Voxtur, nuk janë në përputhje me katalogun e dorëzuar për këtë kompani;
- Kontrata e Huapërdorjes, bashkëngjitur vertetimit të OShEE, nuk është nënshkruar para noterit si dhe nuk është e periudhës aktuale (dt. e kontratës është 05.10.2018 - 31.12.2018).

Nga formulimin që Autoriteti Kontraktor ka bërë, asnjë prej prej arsyeve apo arsyetimeve mbi të cilat janë paraqitur për të mbështetur skualifikimin, referuar Dokumentave të Tenderit (DT) apo akteve normative për prokurimin publik nuk qëndron, ato janë thjesht konstatime të paarsyetuara apo edhe sqaruara. Bazuar në aktet normative përkatësisht në Nenin 53 pika 1 të LPP, do të duhej thjesht të kërkohej sqarim për të gjitha këto pika.

1. “Formulari ofertes nuk është i qartë, pasi OE ka deklaruar për secilin Artikull 2 Prodhues dhe 2 vende origjine;” Formulari i Ofertes është fare i qartë: OE ka deklaruar për secilin Artikull 2 Prodhues dhe vendet perkatese të origjinës së produkteve. Njeri është Demophorius me facilitete në Qipro dhe Kine, tjetri është Voxtur, Indi. Sipas përcaktimit të pikës 1.3/b të Kapaciteteve Teknike /Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, për origjinën e mallit kërkohej: “Vetëdeklarate për origjinën e mallit ku të përcaktohet vendi i prodhimit dhe kompania prodhuese (të plotësohet në shtojcën 1 të DST)”. OE e ka bërë këtë deklaram. Pra Oferta ekonomike është e rregullt formalisht,

sipas Shtojcës I të DT dhe arsyetimi “Formulari i ofertes nuk është i qartë” nuk qendron, madje, ne vetvete, nuk është arsyetim. Neqoftese AK do të ishte i paqartë, do të duhej të procedonte sipas Nenit 53 pika 1 të LPP. Persa i perket faktit se: “OE ka deklaruar për secilin Artikull 2 Prodhues dhe 2 vende origjine”, kjo nuk perbën shkak për skualifikim, por, perkundrazi është e ligjshme. Në praktikën e prokurimeve të realizuara nga vee Q.S.U.T. si edhe Ministria e Shëndetësisë në procedurat e përqendruara, është proceduar ndër vite me shumë oferta me shumë se 1 (një) MAH/Prodhues për të njëjtin produkt, oferta të cilat janë kualifikuar nga i njëjti KVO i QSUT si edhe ai i Ministrisë së Shëndetësisë dhe kanë vazhduar realizimin e kontratave.

2. “Katalogu i të 2 prodhuesve, perkatesisht Demophorius dhe Voxtur, nuk janë perkthyer dhe noterizuar, sipas DST pika 2.3/dh”. Në pikën 1.3/dh të DT është kërkuar: “Për të gjithë artikujt e ofruar të paraqiten katalogje, ku të përshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull (pjesët specifike të katalogut ku jepen karakteristikat e artikullit që prokurohet, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen”. KVO, për të justifikuar refuzimin, tjeterson kërkesën 1/3, dh, të AK të paraqitura në DT, me formulimin (citojme): “Katalogu i të 2 prodhuesve, perkatesisht Demophorius dhe Voxtur, nuk janë dorëzuar të perkthyer dhe noterizuar, sipas DST, pika 2.3/dh;” AK, sipas DT ka kërkuar tuba: “1.Lithium Heparin për Plazem, Sistem i mbyllur me vakum. Tapa Jeshile 3-4 ml, 13X75mm 2.Sodium Citrate Plasma për teste koagulimi, Sistem i mbyllur me vakum. Tape Bojëqielli 2.7-4.5 ml, 13X75mm 3.K3 Potassic EDTA për teste hematologjike, Sistem i mbyllur me vakum. Tape Lejla 2-3ml, 13X75mm 4.Gel Silica Serum, Sistem i mbyllur me vakum. Tape e Verdhe (ose e Kuqe) 3-5ml, 13X75mm ose 13X100mm”. Sic qartazi verëhet, AK ka përdorur terma teknike të paperkthyer. Për listën e mallrave, për Lotin-I0, nga ana e AK janë përdorur terma apo shkurtime/akronime nderkombetare, të cilat janë të njëjta me ato të paraqitura në kataloget e paraqitura. Faktikisht, duke konsideruar se standartizimi dhe unifikimi i termave dhe procedurave në teknologji është një fakt i pranuar nga ambjentet shkencore apo teknike, perkatesisht edhe në QSUT, e gjykojmë korrekte paraqitjen në listën e mallrave të emertimeve të artikujve, metodave apo parametrave me terma nderkombetare, në përputhje me kuptimin e Nenit 23, pikat 3 dhe 4, të LPP. Në kataloget e paraqitura nga Lasermed shpk, përshkrimi i tubave, parametrave të shprehura në shifra dhe njësi metrike nderkombetare, është i njëjti si ai i formuluar në Dokumentat e Tenderit. I vetmi perkthim që do të mund të bëhet do të ishte ai i ngjyrave, që sidoqoftë, për ata që nuk i kuptojnë në gjuhën angleze është i paraqitur edhe me elemente kromatik në katalogun e Voxtour. Sic parashikohet në DT, fund të kritereve të kualifikimit, citojmë se “Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.” Në këtë prizem, mosdorëzimi i katalogut dhe jo përkthimi i pjesëve specifike të katalogut ku jepen karakteristikat e artikullit që prokurohet (që e perserisim: e konsiderojmë të pa nevojshëm dhe të pamundur për shkak se janë terma dhe parametra nderkombetare, të përdorura edhe në Shqiperi, si edhe nga vete AK në DT), do të mund të perbente kusht skualifikimi. Për sa argumentuam me sipër, gjykojmë se duke u bazuar në nenin 53 pika 1 dhe 4 të LPP, KVO nuk mund të skualifikoje ofertën e Lasermed shpk për shkak të mosperkthimit të zotëruar në shqip të fjalëve blue, green, red, yellow dhe lavender nga gjuha angleze, duke sjelle për pasoje shpalljen fituese të një oferte me vlerë më të lartë.

3. KVO pretendon se: “Nuk është dorëzuar kopje e certificates për normat 98/79/EC për Demophorius, OE pra ka dorëzuar një deklaratë eksporti të leshuar nga Ministria e Shëndetësisë/Qipro, jo sipas kërkesës në DST pika 23/ç; OE ka dorëzuar vetëm autodeklaratë e

konformitetit per normen 98/79/EC per Voxturn, pa kopje te certificates bashkengjitur; sipas kerkeses ne DST pika 2. 3/ç”. Ne kriterin e parashikuar ne piken 1.3/ç (dhe jo 2.3.ç) te Kriteve te veçanta thuhet : Kerkohet Autodeklarate per materialet mjekesore, kite, reagent, konsumabilet nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) per konformitetin me normat MDD 93/42/EEC ose 98/79/EC ose 98/34 EC si dhe certificate ISO 9001, ose EN ISO 13485, ose (CE/DC (Deklarate Konformiteti) kur është e aplikueshme sipas Direktivave dhe klasifikimit të Keshillit te Europes”. Si shihet ne kerketat e DT kërkesa e AK është me alternativa dhe kur është e aplikueshme “autodeklarate si edhe certificate ISO ose EN ISO 13485, ose CE/DC (Deklarate Konformiteti) kur eshte e aplikueshme sipas Direktivave dhe klasifikimit te Keshillit te Europes”. Pra AK, qartesisht kerkon ose ISO apo Deklarate Konformiteti sipas Direktivave dhe klasifikimit te Keshillit te Europes dhe nuk kerkon qe te paraqiten te dyja, per me teper kur eshte e aplikueshme. Per prodhimet e Kompanise Voxturn ka Autodeklarate per konformitetin nga prodhuesi Voxturn si edhe Distributori Lasermed dhe certificate ISO, gje qe eshte plotesisht sipas kerkeseve te pikes 1.3/ç. Per kompanine Demophorius eshte paraqitur autodeklarate nga ofertuesi Lasermed, qe ne rastin konkret është edhe distributor, ne përputhje me kerkesen e AK “ofertuesi (distributarti/prodhuesi), si edhe nga Ministria e Shendetesise se vendit perkates. Besojme se KVO ka patur per qellim qe te kete garancine e cilesise se produkteve dhe nese mjaftohet me autodeklarate nga (distributori/prodhuesi), pra edhe nga Lasermed shpk (qe edhe ai ka deklaruar perputhshmerine me Autodeklarate), besojme se duhet te marre parasysh edhe nje deklarate nga Ministria e Shendetesise se vendit perkates, qe është edhe organi me i larte per kontrollin e respektimit te standarteve, si edhe certificate zyrtar.

4. Nuk është arsyetim, por konstatim formulimi se: “Mostra e dorezuar per artikullin 1 dhe 3, te Voxturn, nuk jane ne perputhje me katalogun e dorezuar”. Duke mos qene i tille, është i pavlefshem per te qene arsye skualifikimi. Per kete kemi kerkuar zyrtarisht informacion ne dt. 21.03.2018, prane AK, ne perputhje me nenin 21, paragrafet 1 dhe 2(b), te ligjit “Per Prokurimin Publik”, informacion i cili nuk na ka ardhur ende. Nga verifikimet qe kemi bere ne katalog kemi konstatuar:

- Per Artikullin 1 është kerkuar: Lithium Heparin per Plazem, Sistem i mbyllur me vakum. Tapa Jeshile 3-4 ml. Ofruar dhe dorëzuar mostra 60VT10804 VacTube Lithium Heparin 13x75mm 4 ml me tapë jeshile.

-Artikulli 3, është kerkuar: K3 Potassic EDTA per teste hematologjike, Sistem i mbyllur me vakum, Tape Lejla 2-3ml, 13X75mm; Ofruar 60VT10202 VacTube EDTA K3 13x75mm 2 ml me tapa lejla; Mostra e dorëzuar 60VT10204 VacTube EDTA K3 13x75mm 4ml me tapa lejla;

Pra vetem kjo moster e paraqitur prej nesh, vetem per kete produkt dhe vetem per kete kompani, ka nje volum tjeter. Kerkesa e paraqitjes se mostrave eshte nje kerkese per te vleresuar cilesine, performancen dhe aftesise thithese ne vakum. Per volume të ndryshme tubat jane te njejte ne kualitet dhe ndryshimi është vetem ne volum. Sigurisht volumi eventualisht i kontraktuar dhe furnizuar, do te jete sipas kerkeseve te AK dhe nenvizimit ne katalog. Kete mosperputhje nga katalogu, AK do te duhej ta konsideronte “devijim i vogel qe nuk ndryshon materialisht ose nuk devijon nga karakteristikat” sipas kerkeseve te Nenit 53, pika 1 dhe 4 të LPP. Panvaresisht nga kjo, (edhe pse nuk e konsiderojme kusht skualifikimi ne vetvete), perderisa mostrat e tjera te paraqitura, per te cilat ju nuk keni paraqitur ndonje kundershiti, jane pranuar, kjo do te mjaftonte per te mundesuar kualifikimin e OE me artikujt te cilat jane ne përputhje me katalogun.

5. “Kontrata e Huapendorjes, bashkengjitur vertetimit te OShEE, nuk është nenshmar para noterit si dhe nuk është e periudhes aktuale (dt. e kontrates është 05.10.2018-31.12.2018).” Persa i perket Kontrates se Huapendorjes, evidentojme se nuk është dokument qe verteton permbushjen e ndonje kriteri te pergjithshem apo te vecante kualifikimi, pra, duke mos qene kerkese ne DT, nuk mund te jete arsye skualifikimi. Meqenese nga AK është dhene arsyetim me i plote per disa nga mangesite e pretenduara he renditura me siper, sqarojme se dokumenti është ngarkuar ne sistem per te shmangur ndonje paqartesi, apo moskuptim te mundshm nga ana KVO-se per Vertetimin qe konfirmon shlyerjen e te gjitha detyrimeve te maturuara te energjist elektrike te kontratave te energjiise, pasi Laser Med shpk nuk ka nje te tille. Edhe Ekstrakti i QKB-se i cili gjithashtu nuk kerkohet ne DT, është futur per te qartësuar se Laser-Med shpk ka te njejten adrese zyrtare me ate te Megapharm shpk, sic dhe figuron ne dokumentin e leshuar nga Zyra e OShEE: “vertetojme se kerkuesi LASER-MED verifikimet e kryera ne Sistemin e faturimit, per kontraten/kontratat (me kod TR3M110064551335 titullar i se ciles/cilave eshte Shoqeria Megapharma rezulton te ketë në total 0 leke detyrime per faturat e energjiise elektrike, vlere e llagaritur deri ne daten 01.03.2018”. Gjithesesi, nje kontrate Huapendorje, jo domosdoshmerisht duhet te jete nenshkruar para noterit dhe, e dyta. data e kontratës është 05.01.2018, dhe afat ka gabim material ne daten e fillimit te afatit (jo dt. e kontrates sic gabim është shkruar ne njoftimin e AK). Ky gabim, mund he jete ne disfavor te njerit prej paleve nënshkmes te kontrates se huapendorjes, por jo shkak per skualifikim. Gabimi material i dates se fillimit te kontrates, i konstatuar nga KVO, do te ishte ekuivalent me referencen e gabuar te pikes 2.3 te perdorur nga vete KVO per arsyetimin e refuzimit te ofertes. Po te perdorej gjykim analog per kete reference te gabuat, edhe refuzimi do ishte formalisht I pavlefshem. Si perfundim, mbëshhetur në arsyetimin dhe argumentet e mësipërm kërkojme: Te pranohet oferta e Laser Med sbpk dhe, duke qene se është oferta me ulet, te shpallet fituese per Lotin 10 - “Tuba dhe konsumabile laboratorike per fazen preanalitike te perpunimit te gjakut”.

II.5. Në datën 03.04.2018, nëpërmjet shkresës me nr. 1731/3 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues, duke e pranuar pjesërisht ankesën e paraqitur, konkretisht ka pranuar dy nga pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankimues dhe ka refuzuar tre pretendimet e tjera.

II.6. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik, në rivlerësimin procedurës, datë 12.04.2018, operatori ekonomik ankimues “Laser Med” sh.p.k. rezulton i skualifikuar për tre arsye:

Bazuar në vlerësimin e KSHA me nr.1731/2 dt.03.04.2018; pranohet Pretendimi i parë dhe i pestë dhe nuk pranohet pretendimi i dyte, i treti dhe i katerti të OE. Per sa me siper qendron vlerësimi për:

- Katalogu i të 2 prodhueseve, perkatesisht Demophorius dhe Voxtur, nuk janë dorezuar të përkthyer dhe noterizuar, sipas DST pika 2.3/dh.
- Nuk është dorëzuar kopje e certifikates për normat 98/79/EC per Demophorius, OE ka dorëzuar një deklaratë eksporti te leshuar nga Ministria e Shëndetësisë/Qipro, jo sipas kerkeses ne DST pika 2.3/ç.

- Mostra e dorezuar per Artikullin 1 dhe 3, te Voxtur, nuk jane ne perputhje me katalogun e dorezuar per kete kompani, në vijim të shkresës sqaruese me nr.1687/1 prot., dt. 21.03.2018.

II.7. Në datën 11.04.2018 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke ngritur pretendime për arsyet e skualifikimit të cilat nuk u pranuan nga autoriteti kontraktor në ankesën e drejtuar pranë këtij të fundit. Konkretisht:

1. Ne ankimin drejtuar AK kemi theksuar, qe ne fillim se: “asnje prej arsyeve apo arsyetimeve te paraqitura per skualifikim, referuar Dokumentave te Tenderit (DT) apo akteve normative per prokurimin publik nuk qendron apo jane thjesht konstatime të paarsyetuara apo edhe sqaruara”. Pas marrjes se pergjigjes nga AK, konstatojme se, jo vetem gjykimi yne per mos arsyet e refuzimit te ofertes qendron por edhe se argumentat e paraqitura nga AK ne pergjigje te ankimit jane kontradiktore, nuk i referohen rigorozisht formulimevc te Dokumentave te Tenderit dhe, ne nje rast, nuk i referohen as edhe fakteve te kontestuara ne mesazhin elektronik, e te kundërshtuara nga ana jone, por mospranimin e mostrave, sillen argumente te tjera, per artikuj te tjere, qe me pare ishin pranuar. Kendveshtrimi subjektiv i AK, jo konform akteve normative qe rregullojne Prokurimin Pubhk dhe procedurat e tij dhe frymes se tyre ne pergjithesi te konstatuara ne rastin tone, si dhe per vleresimin per oferten, arsyetimet e perdorura ndaj argumentave te paraqitura ne ankimin e LaserMed shpk per shkaqet e skualifikimit, referimin e pasakte dhe në me shume se nje here jokorrekt ndaj legjislacionit, apo pershkrimeve ne Dokumentat e Tenderit (DT), kushtezon, qofte skualifikimin e ofertes, ashtu edhe mospranimin (e pjesshëm) te ankeses. Kundërshtimi i LaserMed shpk konsiston pikerisht ne faktin se oferta eshte ne perputhje me pershkrimin e kriterëve, kërkesave dhe specifikimeve te DT, pa paragjykuar mbështetjen e kriterëve, kërtimeve dhe specifikimevc te DT ne aktet normative shqiptare qe rregullojne lenden, apo dhe aktve te drejtes publike nderkombetare, por ne kriteret e gjykimit dhe vleresimit te ofertes nga ana e KVO, perderisa nuk kemi paraqitur asnje kerkese per ndryshime ne kriteret e DT. Pergjigja e AK ka vleresime dhe gjykime, qe ne jo pak raste: i referohet ne menyre te pasakte dhe evazive akteve normative, sic eshte rasti i referimit per perkthimin, ku ne te gjitha referencat normative (LPP, VKM 914/2014) behet fjale per perdorimin e gjuhes shqipe ne proceduren e prokurimit dhe hartimit te dokumentacionit; tejkalojne kërkesat e DT, si me rastin e kërkeses per Certifikatën CE si kusht skualifikues, nderkohe qe ne DT eshte nje alternative; kërkojne domodoshmerisht vertetimin ne menyre deklarativc (deklarate konformiteti) referuar normave komunitare te BE te pasaktesuara citojme: kur eshte e aplikueshme sipas Direktivave dhe Klasifikimit te Keshillit te Europes., te cilat parashikojne ndryshe dokumente te tille per procedura ne fjale (apo dhe norma ate abroguara -Direktiva 93/42/EEC e Keshillit), kur vete shtetet pjestare te BE nuk kane nje praktike te unifikuuar; jane kontradiktore per te njejtin objekt ne kohe te ndryshme (ne njoftimin e skualifikimit behet fjale per Artikujt 1 dhe 3 te shoqerise Voxtur, ndersa ne pergjigje te ankeses, rezultojne te pranuar dhe KShA, (KShA, jo vetem shqyrton ankesen por edhe “rremon” per te gjetur shkaqe shtese per skualifikim) njofton se nuk pranohen mostrat per artikujt 2 dhe 4); me apo pa qellim ndryshohet ose tjetërsohet perkatesia e dokumentit, pa e pershkruar ne menyre korrekte (Certifikata e Shitjes se Lire-CF S, ne arsyet e skualifikimit cilesohet Deklarate eksporti, ndersa ne pergjigjen e ankimit korrigjohet, por jo korrekt, ne Certmkate eksporti (e para eshte dokument qe leshohet nga autoritetet doganore, e dyta nuk mund te shprehem se nga ç’autoritet leshohet sepse nuk njohim te tille), nderkohe qe ka emertimin sipas Direktives EEC ne origjinalin

anglisht dhe perkthimin shqip!? Ne arsyet e skualifikimit dhe, ne vijim ne pergjigjen e ankimit eshte evident se AK mban qendrim, qe do ta cilesonim paragjykues. Ne pergjigje afirmohet, se “ne nje procedure prokurimi” subjekti i pare i interesuar eshte operatori ekonomik, i cili pergatit oferten ekonomike ne perputhje me kuadrin ligjor ne fuqi, dhe nga ana tjetere eshte autoriteti kontraktor, i cili perzgjedh operatorin ekonomik qe ploteson te gjitha kriteret e percaktuara nga autoriteti kontraktor ne dokumentat e tenderit dhe qe pergatit oferten ne perputhje me lex specialis. Ne kuptimin si lex specialis mbi lenden, pra te Ligjit nr.9643, date 20.11.2006 “Per Prokurimin Publik”, thjesht po evidentojme se nuk ka renditje “te interesuar te pare” apo te dyte ne nje procedure prokurimi dhe, aq me pak, t’i jape rolin e arbitrit apo gjyqtarit autoritetit kontraktor; ne kuptimin e ligjit, autoriteti kontraktor, “vlereson nje oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit ” (Neni 53/2 LPP). Kjo nuk do te thote se formulimi I kriterëve apo kerkesave qe duhen permbushur eshte formuluar ne menyre te tille qe e lejon operatorin ekonomik te paraqese oferten ne perputhje me pershkrimin formal te bere nga vete AK, ne dokumentat e tenderit, pavarsisht se qellimi per vendosjen e kriterit nga AK, mund te kete qene i ndryshem. Pa pasur apak qellim interpretimi, por vetem per mbeshtetje te argumentave qe do te sjellim per te ankimuar vendimin perfundimtar te autoritetit kontraktor, do te evidentonim se jurisprudenca administrative (te ciles i referohet AK ne vleresimet e veta) ka dy qendrimet kryesore doktrinare per lex specialis, si teresi e publikimeve, dokumentave, kerkesave, kriterëve, etj. te nje procedure prokurimi publik, qe permblodhësi, jane: I. “Dyshimer qe dalin nga interpretimi i lex specialis (gjithnje me referim kerkesat apo kriteret shenim), duhet te zgjidhen ne baze te arsyes duke iu referuar permbajtjes substanciale te kerkesave/kriterëve dhe jo ngushtesisht (Stricto sensu) pershkrimet formal te tyre. Ne gjykimin tone, nga ky parim eshte orientuar edhe Ligji shqiptar per prokurimet publike, Neni 53/4, ku parimi i mesiperm gjen aplikim. AK, sic dhe me siper eshte cituar ne pergjigje, nuk orientohet as nga parimi i jurisprudences dhe as nga dispozita e ligjit. Por anon nga qendrimi i dyte 2. “Kriteret dhe pershkrimet e percaktuara ne lex specialis jane detyruese jo vetem per operatorët ekonomike pjesemarres ne tender, por edhe per vete administraten (AK) te ciles nuk i perket asnje marzh diskrecionaliteti ne zbatimin e tyre konkret dhe as nuk mund te mos i aplikojë ato, madje edhe ne rast se disa nga keto kriteret dhe pershkrime jane te formulura ne menyre te papershtatshme ose ne mosperputhje me specifikimet, perjashtuar mundesine e procedures se anullimit ne ushtrim te te drejtes se shmages se nje demit te mundshem. Nisur nga kjo pikpamje, pra te qendrimit strikt te pershkrimet te kriterëve qe duhen permbushur te pershkrues ne Dokumentat e Tenderit, AK eshte i detyruar te perjashtojë, sipas parimit Lex specialis derogat legi generali, nje nga kundërshtite (antimonite), nga ai vete te formuluar. Ne kete prizem, kerkesa e kriterit te veçante (1.3/dh) te DT: “pjesët specifike te katalogut ku jepen karakteristikat e artikullit që prokurohet, nëse nuk janë në gjuhën shqipe të përkthehen dhe të noterizohen” do te duhej te prevalonte mbi arsyetimin e KShA per mospranimin te ankeses se oE: “Nese gjuha e perdorur ne procedure eshte gjuha shqipe, atehere dokumentat ne gjuhe te huaj duhet te shoqerohen me nje perkthim te noterizuar ne gjuhen shqipe”. II. Ne pergjigje te ankeses per skualifikimin nga KVO, arsyeton, ne gjykimin tone, duke dhena arsyetime jo mbi argumentet e dhena nga LaserMed per permbushjen e kriterëve formalisht te shprehura ne DT, por interpretimin e vete ketyre kriterëve. II.1. Per te arsyetuar se pretendimi per perkthimin e katalogeve nuk pranohet, AK i referohet akteve nonnative: neni 46/1 dhe 53/3 te LPP, neni 14 te VKM nr.114/2014 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, ku me te dy nenet e ligjit

nuk behet fjale per dokumenta te perkthyer. Ndersa ne VKM, neni 14, qe jepet per te mbeshtetur arsyetimin, faktikisht eshte se si duhet te formulohen Udhezimet per ofertuesit/kandidatet, pra i drejtohet Autoriteteve Kontraktore per pergatitjen e dokumentacionit te prokurimit, te cilet ne rastin e e procedurave te prokurimit mbi kufijte e larte monetare, dokumentet e tenderit duhet te hartohen ne gjuhet shqip dhe anglisht, ndersa, po ne vijim te pikes dy te po ketij neni, vijohet- Ne procedurat e prokurimit nen kufijte e larte monetare gjuha e perdorur eshte gjuha shqipe. Ne dijenine tone, nuk ka akt normativ qe te regulloje ceshtjen e dokumentave te perkthyer ne procedurat e prokurimit. Eshte e drejte e Autoritetit Kontraktor te percaktoje ne Dokumentat e Tenderit kriteret dhe dokumentat qe vertetojne permbushjen e tyre. Por, kundërshtimi jone per skualifikimin ne kete pike eshte se kërkesa e bere nga Autoriteti kontraktor eshte permbushur dhe AK nuk i referohet ne menyre korrekte ketyre dokumentave, duke u shprehur se: kataloget e paraqitur nga operatori ekonomik ankimes nuk jane paraqitur ne gjuhen shqipe dhe nuk jane te perkthyer sipas kërkesave te DST dhe dispozitave ligjore. Duke mos ju referuar asnje kuadri ligjor, referenca behet me Kriteret e Pergjithshme Nese gjuha e përdorur ne procedure eshte gjuha shqipe, atehere dokumentat në gjuhe te huaj duhet te shoqerohen me nje perkthim te noterizuar ne gjuhen shqipe. AK nuk i referohet kriterit te vecante (1.3/dh) te DT: pjeset specifike te katalogut ku jepen karakteristikat e artikullit qe prokurohet, nese nuk janë ne gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen. Po ashtu, ç'ka e konsiderojme jo te ligjshme, AK mer persiper te interpretoj kriteret nga vete ai te formuluar, duke percaktuar dhe valencen e tyre: i gjithë dokumentacioni pa perjashtim i paraqitur ne proceduren e prokurimit duhet te jete ne gjuhen shqipe ose i perkthyer i noterizuar, duke shtjelluar interpretimin, por jo argumentimin: “percaktim ky gjithëperfshires qe i perket cdo lloj dokumentacioni qe do te paraqitet ne kete procedure prokurimi.” Nuk eshte pergjegjesi e Operatorit Ekonomik fakti se cilin nga dy formulimet duhet te marre ne konsiderate, aq me pak eshte pergjegjesi e AK te vendose per aktet e tij, duke percaktuar precedente. Nisur nga parimi Lex specialis derogat legi generali, (Ligji norma e vecante perjashton Ligjin/Normen e pergjithshme) gjykojme se pershkrimi, te cilit nuk i referohet AK, ‘pjesët specifike të katalogut ku jepen karakteristikat e artikullit që prokurohet nese nuk janë në gjuhën shqipe të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen’ prevalon mbi formulimin e rregullit te pergjithshem. Arsyetimi i AK duke ju referuar “percaktimit gjithëperfshires ne gjykimin tone behet per te shmangur thelbin e arsyetimit tone per kete pike: faktin se tekstualisht kerkohet perkthim i pjesshem, duke shmangur argumentin tone, te arsyetuar me poshte, se percaktimet ne katalog jane terma/emertime dhe njesi metrike qe nuk perkthehen, te perdorura nga vete AK ne pershkrimin e mallrave ne listen e DT. Per kete pike, paraprakisht sqarojme se KVO, per te justifikuar refuzimin, tjeterson kërkesen 1.3,dh, te pershkruar ne DT, me formulimin (citojme): “Katalogu i te 2 prodhuesve perkatesisht Demophorius dhe Voxtur, nuk jane dorezuar te perkthyer dhe noterizuar, sipas DST, pika 2.3.dh: “AK, sipas DT ka kerkuar tuba: “1.Lithium Heparin per Plazem, Sistem i mbyllur me vakum. Tapa Jeshile 3-4 ml, 13X75mm 2.Sodium Citrate Plasma per teste koagulimi, Sistem i mbyllur me vakum. Tape Bojqielli 2.7-4.5 ml, 1 3X 75mm 3.K3 Potassic EDT A per teste hematologjike, Sistem I mbyllur me vakum. Tape Lejla 2-3ml, 13X 75mm 4.Gel Silica Serum, Sistem i mbyllur me vakum. Tape e Verdhe (ose e Kuqe) 3-5ml, 1 3X 75mm ose 13X100mm”. Sic qartazi verehet, AK ka perdorur terma teknike te paperkthyer. Per listen 6 mallrave. per Lotin-l 0, nga ana 6 AK jane perdorur terma apo shkurtime/akronime nderkombetare, te cilat jane te njejta me ato te paraqitura ne kataloget e paraqitur. Faktikisht, duke konsideruar se standartizimi dhe unifikimi i termave dhe procedurave ne teknologji është

nje fakt i pranuar nga ambjentet shkencore apo teknike, perkatesisht edhe ne QSU, e gjykojme korrekte paraqitjen ne listen e mallrave te emertimeve te anikujve, metodave apo parametrave me terma nderkombetare, ne perputhje me kuptimin e Nenit 23, pikat 3 dhe 4, te LPP. Ne kataloget e paraqitura nga Lasermed shpk, pershkrimi i tubave, parametrave te shprehura ne shifra dhe njesi metrike nderkombetare, është i njejte si ai i formuluar ne Dokumentat e Tenderit. I vetmi perkthim qe do te mund te behet do te ishte ai i ngjyrave, por qe eshte dhene ne menyre grafike ne katalog, pershkrim qe ne fakt eshte edhe i panevojshem sepse ngjyrat e tapave te tubave sipas perberjes ne brendesi te tyre, eshte kodifikim nderkombetar, i pandryshueshem nga prodhuesi. Nuk egziston vendosja e ngjyrave te tapave ne menyre subjektive nga prodhuesi. Me poshte po sjellim krahasimin e kerkesave te AK dhe pershkrimit ne katalog te tubave te kerkuar. Te dyja pershkrimet jane ne latinisht, qe eshte edhe gjuha universale teknike per materiale te tilla. Nëse kërkesat jane ne shqip, atehere edhe pershkrimi ne katalog do te duhej te konsiderohej si i tille. Nga ana tjetere, sic edhe parashikohet ne DT, ne fund te kriterave te kualifikimit (citojme) “Rastet e mosdorezimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.” Ne kete prizem, mos-dorezimi i katalogut, dhe jo perkthimi i pjesëve specifike të katalogut ku jepen karakteristikat e artikullit që prokurohet, (qe e perserisim: e konsiderojme te pa nevojshem dhe te pamundur per shkak se jane terma dhe parametra nderkombetare, te perdorura edhe ne Shqipëri, si edhe nga vete AK ne DT), do te mund te përbente kusht skualifikimi. Per sa argumentuam me sipër, gjykojmë se duke u bazuar ne nenin 53 pika 1 dhe 4 te LPP, KVO nuk mund te skualikojte ofertën e Lasermed shpk per shkak te mos perkthimit ne shqip te pershkrimeve te njejta ne katalog; duke sjelle per pasoje shpalljen fitues te një oferte me Vlere me te larte.

11.2. Nga AK pretendohet, por nuk arsyetohet, fakti qe nga LaserMed nuk eshte paraqitur dokument (vetedeklarim, ose certifikate CE) per produktet e Kompanise Demophorius, Qipro. Sic u shprehem edhe me siper vete emertimi dhe referenca qe i ben AK dokumentit te paraqitur nga me e ben te pavlevshem arsyetimin. Madje nuk eshte perdorur arsyetim, duke shmangur dhe vete referimin ne kriterin e percaktuar ne DT (1.3/ç: te Kriterave te Vecanta), qe kerkon dokumenta alternative. Ne njoftimin e autoritetit kontraktor me ane te SPE jepet si shkak per skualifikim fakti se nga LaserMed shpk: “Nuk është dorezuar kopje e certificates per normat 98/79/EC per Demophorius, OE ka dorezuar nje deklarate eksporti te lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë/Qipro, jo sipas kerkeses ne DST pika 2.3/ç OE ka dorezuar vetem autodeklarate e konformitetit per normen 98/79/EC per Voxtur, pa kopje te certificates bashkengjitur; sipas kerkeses ne DST pika 2.3/ç.” Edhe ne pergjigjen per ankimin tone, vetem sa evidenton dhe ben liste te dokumentave te dorezuar, dhe emerton arbitrarisht dokumentin “Certifikate eksporti”. Nderkohe qe nuk jep asnje arsyetim mbi formulimin alternativ per dokumentin qe kerkohet ne permbushje te kriterit te pikes 1.3/ç. Arsyetimi yne konsiston ne dy aspekte: Dokumentat e paraqitur plotesojne kerkesen e AK, pasi nuk kerkohet nje dokument i vetem specitik; Certifikata e Shitjes se Lire e paraqitur eshte plotesisht ne perputhje me referencat qe ka pershkruar vete AK ne Dokumentat e Tenderit. Formulimi ne DT eshte: Kerkohet Autodeklarate për materialet mjekesore, kite, reagente konsumabile nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) për konformitetin me normat MDD 93/42/EEC ose 98 79 EC ose 98/34EC si dhe certifikate ISO 9001 ose EN ISO 13485, ose CE/DC (Deklarate Konformiteti) kur është e aplikueshme sipas Direktivave dhe klasifikimit te Keshillit te Europes. Pra, ne kerkesen e DT kërkesa e AK është me alternativa, si dhe ne rastin kur është e aplikueshme citojme nga DT: “autodeklarate si edhe certifikate ISO ose EN ISO 13485,

ose CE/DC (Deklarate Konformiteti) kur është e aplikueshme sipas Direktivave dhe klasifikimit të Keshillit të Europës. Pra AK, qartësisht kërkon ose ISO apo Deklarate Konformiteti sipas Direktivave dhe klasifikimit të Keshillit të Europës dhe nuk kërkon që të paraqiten të dyja, për më tepër kur thekson “kur është e aplikueshme”. Për të dyja kompanitë është paraqitur autodeklarate nga operatori ekonomik Laser Med, që në rastin konkret është edhe distributor, në përputhje me kërkesën e AK “ofertuesi (distributori/prodhuesi) si edhe Certifikate ISO 9001, për të dy operatorët. Me kësaj përbushen kërkesat e pikës 1.3/ç. Posaçërisht, përveç dokumentave që përbushin kërkesat e kësaj pike, OE ka paraqitur edhe dokumentet e tjera, që në mënyrë të cuditshme janë paraqitur si subjekt të pretendimit për skualifikim. Për kompaninë Demophorus është paraqitur nga Ministria e Shëndetësisë së vendit perkates Certifikata e Shitjes së Lire, që certifikon përbushjen e kërkesave të direktivave të KE (që sigurisht e tejkalon autodeklaraten e leshuar nga “ofertuesi (distributori/prodhuesi), apo Deklarate Konformiteti të leshuar nga prodhuesi. Posaçërisht për këtë dokument, me mendim shumicë, AK pretendon skualifikimin. AK nuk sqaron apo arsyeton se përse dokumenti i paraqitur nga LaserMed nuk është në përbushje të kërkesës (alternative) të shprehur në DT, edhe pse nisur nga formulimi i pikës 1.3/ç të Kriterëve të Vecanta, në gjykimin tonë do të mjaftonte vetedeklarimi i bërë nga nësi distributori i autorizuar. Certifikata e Shitjes së Lire (CFS) leshuar nga Ministria e Shëndetësisë Qipro është teresisht e rregullt në përputhje me “Direktivave dhe klasifikimit të Keshillit të Europës” dhe përbush kërkesën e kriterit të sipërcituar. Ndryshe nga arsyetimi i munguar i shumicës, në përgjigje është pasqyruar mendimi i argumentuar dhe i shtjelluar i pakicës, që e gjykon të rregullt dokumentin. Gjithësesi, edhe këtij arsyetimit i mungojnë disa saktësime dhe perditesime me normative të KE. CFS nuk është vetëm (citohet) vertetim i bërë nga personi përgjegjës i BE-së së produktit(et) është në përputhje me Rregulloren e BE-së për produktet kozmetike. Faktikisht CFS leshohet edhe për pajisjet mjekësore. Parashikimi i Certifikates së Shitjes së Lire (CFS) parashikohet nga Rregullorja Direktiva EU 2017/745 e datës 5 Prill 2017, Neni 60 nga njera anë, dhe nga ana tjetër, kjo Direktive përjashton “normat MDD 93/42/EE C”, të kërkuara nga AK (dokumenti bashkëngjitur).

II.3. KShA, në kthimin e përgjigjes së ankimit të OE, përshkruan skualikimin e OE LaserMed shpik me argumentin e marrë nga SPE: Megjithatë nuk gjendet në citimin e mesipër, KShA ka argumentuar si arsye për skualifikim edhe pretendimin e katërt të OE, në ankesën drejtuar AK. Në fakt, në SPE ka dalë në një kohë të mëvonshme edhe një pretendim shtesë për skualifikim, pretendim ky i ankimuar qorrazi nga OE, sepse nuk mori asnjëherë përgjigje ndaj kërkesës për sqarim (kërkesa bashkëngjitur i është paraqitur KVO si në mënyrë elektronike ashtu edhe me postë). Ky pretendim ka qenë: Mostra e dorëzuar për artikullin 1 dhe 3, të Voxtur, nuk janë në përputhje me katalogun e dorëzuar për këtë kompani; Në “Argumentimin për pretendimin e katërt” KShA, citon relacionin e “Relacion për testimin e mostrave të tubave të gjakut në laborator” i cili ka konstatuar se: Mostra nr.7 tub gjaku tip: VACTUBE VOXTUR rezulton se i plotëson specifikimet teknike për artikullin nr. 1 dhe 3 të kërkuara në DST. Konstatohet se artikulli nr. 2 dhe 4 ka një etiketim të ndryshëm nga dy artikujt e tjerë. Për këtë KShA, pranon në përgjigjen e tij, citohet: “Në kushtet kur këto dy mostra (artikulli nr.1 dhe nr. 3) referuar dhe relacionit të Sherbimit të Laboratorit Biokimik Klinik, përputhen me specifikimet teknike në DST dhe kodet e markuara në katalog, atëherë ato do të konsiderohen se i plotësojnë kërkesat e AK. KShA, jashtë kompetencave të tij, nuk është mjaftuar me shqyrtimin e ankimit, por ka marrë persipër rolin e KVO, duke paraqitur argumente shtesë për të patur domosdoshmërisht një

skualifikim dhe arrin ne konkluzionin se: “artikut e ofruara nga prodhuesi Voxtur Bio LTD, nuk jane sipas kerkesave te DST dhe OE LaserMea’ nuk pranohet per produktet Voxtur por pranohet per produktet Demophorius”. “Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik “Laser-Med” shpk, nuk qendron”. Pretendimi i OE LaserMed shpk, ka qene se artikujt 1 dhe 3 te Voxtur, i permbushin kerkesat e DT. Ne kuptimin e pretendimit per skualifikim nga KVO, kjo do te ishte e mjaftueshme per te pranuar ankimimin e OE. Sidoqofte, duke u nisur nga pohimi i KShA, minimumi artikujt 1 dhe 3, mund te furnizohen nga OE, pas nje kontrate te mundshme. AK do te mund te furnizohej me keto produkte edhe pjeserisht dhe nuk mund te skualifikohet e gjithe oferta e Voxtur perderisa prodhuesi tjetër është kualifikuar. Pamvaresisht nga kjo, ne do te argumentojme edhe Vlefshmerine e ofertes per artikujt 2 dhe 4 per te cilat relacioni i Sherbimit te Laboratorit Biokimik-Klinik nuk shkruan se jane te papershtateshme por vetem se “Konstatojme se artikulli nr. 2 dhe 4 ka nje etiketim te ndryshëm nga dy artikujt e tjere.” Pretendimi i KShA. per puvlefshmerine e ofertes se artikujve 2 dhe 4 te prodhuesit Voxtur është si me poshtë: "Tubat me tapë të kuq (Artikulli 4) dhe bojëqiell (Artikulli 2) emri Vactube nuk është i shënuar në fushë me ngjyrë të njëjtë me Tapën; kanë etiketim me fushë të bardhë, pa ndarjet ku shkruhen të dhënat e pacientit/gjakut: emri, mbiemri, data etj. Tubat nuk kanë shenjën CE në etiketë dhe nuk kanë të shkruajtur në etiketë emrin ose logon e prodhuesit Voxtur Bio LTD. Nga krahasimi me fotot në katalogun e dorëzuar për Voxtur, këto tuba rezultojnë se nuk janë të ngjashëm me Tubat me tapë të kuqe dhe bojëqiell në katalog”. Duam te theksojmë se të vetmet kerkesa teknike jane: Perberja kimike brenda tubit (i shoqëruar me ngjyren e detyrueshme konvencionale te tapes), b. te jene nen vakum, c. volumi i percaktuar brenda nje diapazoni nga AK. Qëllimi i dorezimit te mostrave eshte për te testuar performancën e tyre dhe si të tilla i janë paraqitur KVO, etiketa eshte nje detaj i cili nuk mund të paraqitet si argument skualifikimi për arsyet e meposhtme:

a. Në asnjë vend në DT nuk ka kerkesa specifike per etiketen.

b. Fotot në katalog jane orientuese si pranohet dhe nga vetë KSHA:

"Në lidhje me fotot që nuk perputhen me ato ne katalog, theksojme se markimet e vetme ne katalog per këto dy produkte jane jo m fotot por kodet dhe parametrat e tyre te cilat jane te njejta me ato të mostrave. Jo detyrimisht cdo artikull i pershkruar duhet te paraqitur me foto në katalog dhe jo detyrimisht vetëm ai product I demonstruar me foto në katalog është I vetmi lloj produkti". Si edhe: "në kushtet kur dhe këto mostra (artikujt 1 dhe 3) referuar dhe relacionit te Shërbimit të Laboratorit Biokimik-Klinik, perputhen me specifikimet teknike te DST dhe kodet e markuara në katalog, atehere do të konsiderohen se i plotesojne kerkesat e AK". Lind pyetja: perse artikujt 2 dhe 4, që përputhen me specifikimet teknike te DST dhe kodet e markuara në katalog, nuk do të konsiderohen se i plotesojne kerkesat e AK?

c. Fotot në katalog janë orientuese, prodhuesi ka mundësi ti personalizojë ne dizajn dhe ne gjuhën e përdoruesit eliketat sipas kerkesave te blesetit, mundesi qe i ofrohet blesetit nese sasisë janë të përshtatshme si ato të kërkuara nga Ak dhe e lëjon afati i levrimit.

d. Edhe në qoftëse KVO-ja do te kishte ndonjë dyshim, do te duhej t'i referohej Nenit 53, pikat 1 dhe 4 te LPP qe I njohin te drejten AK te kerkoje sqarime plotesuese per oferten dhe te vlerësojë te vlefshme oferten per sa ajo permban devijime te vogla qe nuk cenojne materialisht përmbajtjen e saj.

II.8. Nëpërmjet shkresës me nr. 1987/2 prot., datë 19.04.2018, të protokolluar me tonën në datën 19.04.2018, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni dhe

dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik “Laser Med” sh.p.k. se arsyeja e skualifikimit “*Katalogu i të 2 prodhuesve, përkatesisht Demophorius dhe Voxtur, nuk janë dorëzuar të përkthyer dhe noterizuar, sipas kërkesës në DST pika 2.3/dh*”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit Shtojca 9 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3. “*Kapaciteti teknik*”, gërma “dh”, është përcaktuar: “*(dh) Për të gjithë artikujt e ofruar të paraqiten katalogje, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull (pjesët specifike të katalogut ku jepen karakteristikat e artikullit që prokurohet, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen)*”. Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron sipas numrit rendor (të markuara sipas artikullit) të përcaktuar në formularin e ofertës. Të markohen artikujt që ofrohen të përkthyer. Katalogjet do pranohen vetëm në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit”.

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatorit ekonomik ankimues, rezulton se në sistemin e prokurimeve elektronike, është paraqitur dokumenti me emërtimin “*Katalogu Demophorius*” dhe dokumenti me emërtimin “*Voxtur Bio Bood Collection Tubes Highlighted*”, nga verifikimi i të cilave konstatohet se të dy këta dokumenta janë në gjuhë të huaj.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1 e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese*”.

III.1.4. Në nenin 53, pika 3 e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, parashikohet se: “*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...*”;

III.1.5. Në nenin 14 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, është përcaktuar shprehimisht: “*Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe*”.

III.1.6. Në dokumentat e tenderit, Seksioni IV *Procedura*, pika 4.6 është përcaktuar shprehimisht:

4.6 Gjuha (-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Gjithshtu, në Shtojcën 9 të dokumentave të tenderit, *“Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit”*, përcaktohet shprehimisht se: *“Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe”*.

III.1.7. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se katalogët e paraqitur nga operatori ekonomik ankimes nuk janë paraqitur në gjuhën shqipe, duke e bërë të pamundur identifikimin e plotësisht të specifikimeve teknike sipas përcaktimeve të autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit, për më tepër që nuk janë të përkthyer të paktën vetëm ato pjesë të katalogut që kanë të bëjnë me përshkrimin apo specifikimet teknike të mallit apo produktit të kërkuar, pasi katalogu nuk përmban vetëm të dhëna teknike (si përmasa etj.), por edhe përshkrim të produktit. Përcaktimi i bërë në dokumentat e tenderit, si në seksionin IV, ashtu edhe në Shtojcën 9 Kriteret e përgjithshme të kualifikimit, aq më tepër në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, është përkufizuar qartë që gjuha e përdorur është *gjuha shqipe* dhe rrjedhimisht çdo dokument i paraqitur në gjuhë të huaj duhet të jetë në gjuhën shqipe, ose i përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe, përcaktim ky që vlen për çdo dokument të paraqitur në këtë procedurë prokurimi. Sqarojmë se përkufizimi ligjor i mësipërm është gjithpërfshirës, pra për të gjithë dokumentacionin përkatës që paraqitet në këtë procedurë prokurimi.

III.1.8. Në kushtet kur, në dokumentat e tenderit të hartuara e të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik, e konkretisht në kriteret e përgjithshme, të cilat janë detyrimisht për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë, si dhe detyrimisht për të mos u ndryshuar nga autoriteti kontraktor gjatë hartimit të dokumentave të tenderit, është përcaktuar qartë e saktë që *“Nëse gjuha e përdorur në procedurë është shqip, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe”*, si edhe gjuha e përdorur është përcaktuar *“Gjuha Shqipe”*, atëherë i gjithë dokumentacioni i paraqitur në procedurën e prokurimit duhet të jetë në gjuhën shqipe ose i përkthyer i noterizuar në gjuhën shqipe, përcaktim ky gjithpërfshirës që i përket çdo lloj dokumentacioni që do të paraqitet në këtë procedurë prokurimi nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës. Akoma më tej, nisur nga përcaktimi i bërë në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit (tek të cilat autoriteti kontraktor mund të përcaktojë vetë kriteret që mendon se janë të nevojshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë të interesuar, gjithnjë në përpjesëtim me natyrën dhe vlerën e kontratës, objekt prokurimi), përcaktohet qartë që pjesët specifike të katalogut ku jepen karakteristikat e artikullit që prokurohet, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen. Ndërkohë që edhe ligjvënësi e ka përcaktuar dhe e ka sqaruar mjaft qartë momentin dhe mënyrën e paraqitjes së dokumentacionit në një procedurë prokurimi, përse i përket gjuhës së përdorur.

III.1.9. Referuar seksionit II të dokumentave të tenderit *“Udhëzime për operatorët ekonomikë”* ku përcaktohet se: *“Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme”*, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e ankimesit nuk janë përmbushur të gjitha kërkesat që autoriteti kontraktor ka përcaktuar në këto dokumenta,

pasi ankimuesi është i detyruar të plotësojë çdo kërkesë dhe kriter të vendosur nga autoriteti kontraktor, të paraqesë çdo dokumentacion që përmban të dhëna dhe elementë që janë gjykuar të nevojshëm dhe të domosdoshëm nga ana e këtij të fundit.

III.1.10. Sqarojmë se nëse ankimuesi do të kishte pretendime në lidhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, ai ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës në lidhje me pretendimet e tij parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP, ku parashikohet se: *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”.*

Gjithashtu, në rast se, operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesave për kualifikim, ai mund të paraqiste kërkesë për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave të parashikuar nga neni 42 i LPP-së, ku parashikohet se: *“[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.*

III.1.11. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, makineritë, pajisjet dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi.

III.1.12. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik duhet të dorëzojë të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

III.1.13. Bazuar në sa më sipër KPP sqaron se në një procedurë prokurimi subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me lex specialis.

Për sa më sipër, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Laser Med” sh.p.k. në këtë procedurë prokurimi, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik “Laser Med” sh.p.k. nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk kanë ndikim mbi fatin e çështjes, tashmë që nuk i është pranuar një prej pretendimeve të tij dhe gjendja faktike e juridike e këtij operatori nuk do të ndryshojë duke mbetur i skualifikuar nga procedura në fjalë, ndaj edhe nuk do të merren në shqyrtim, për ekonomi të procedurës administrative.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Laser Med” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me objekt: “Blerje materiale mjekësore të mjekimit, kite reagente dhe materiale konsumi për Laboratorin e Biokimik-Klinik në QSUT; Loti 10: Tuba dhe konsumabile laboratorike për fazën preanalitike të përpunimit të gjakut”, me nr. REF-42098-01-25-2018, me fond limit 14.608.500 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 12.03.2018, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Public Health Sector

Nr. 737 Protokolli

Datë 11.04.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha